

Efektet e përballjes së Amerikës dhe Rusisë në Maqedoni*

21. 05. 2015

Ylli Përmeti

Abstrakt: në këtë artikull tregohet se në Maqedoni zhvillohet së pari një përplasje midis Amerikës dhe Rusisë dhe së dyti, midis partive kryesore në pushtet për pushtet. Për të njëjtën arsye shqiptarët e Maqedonisë duhet të distancohen nga kjo përplasje dhe të ngrejnë fronte popullore për çlirim social dhe kombëtar.

Ndërsa Moska kujtonte “Ditën e Fitores” mbi Nazistët në 9 maj, ne dëshmuam një përleshje me policinë e Maqedonisë. Si fillim ajo ishte një përleshje pa kundërshtar. Por pas disa orësh agjencitë e lajmeve komunikuan “kundërshtarin”: “Ushtrinë Çlirimtare Kombëtare” të Shqiptarëve!¹ Si pasojë, atje humbën jetën 22 njerëz të pafajshëm (14 anëtarë të ushtrisë, tetë policë, shumë të plagosur dhe plotë shkatërrime). Megjithëse ngjarja do të raportohet nga raporti përfundimtar i policisë maqedone, se si filloi, i cili, pa u çuditur, po vonohet, duke gjykuar nga rezultati përfundimtar - ne mund të themi se ajo ka qëlluar pa paralajmëruar. Së pari, sepse policia kishte informacion paraprak për ekzistencën e njerëzve të armatosur. Për të njëjtën arsye ata mund t’a administronin atë ndryshe: duke i rrethuar dhe duke ushtruar presion për t’u dorëzuar. Së dyti, atje ishte një përballje e pabarabartë: një ushtri e plotëfuqishme (forcat shtetërore me armë të rënda), me një forcë shumë të dobët (guerrilasit). Policia, rrjedhimisht, ka shkelur detyrën e saj: sepse policia përpara se të godasë kërkon bisedime paraprake. Sepse roli parësor i policisë është të parandalojë dëmet, dhimbjet dhe gjakderdhjet. Dhe nëse gjykojmë nga deklarata dhe aksioni i guerrilasve, ajo bart tre kontradikta kryesore.

- se ajo pretendon të jetë një ushtri “çlirimtare” për gjithë kombin shqiptar. Kjo është kontradiktë sepse që të përfaqësosh një popull të tërë duhet të miratohesh nga ai;
- se ajo ka goditur ‘si pasojë e terrorit të ushtruar nga shteti policor i Maqedonisë mbi popullatën shqiptare’. Kjo është kontradiktë sepse ajo shpërnjeh lindjen e revoltës “nga brenda”; dhe
- se ajo nuk përmend asgjëkundi të drejtën e popullit të Kumanovës, dhe të çdo populli, për Vetëvendosje dhe për krijimin e një kuadri tjetër institucional përmes të cilit populli shqiptar dhe maqedon të bashkëjetojë në paqe e harmoni. Përkundrazi, ajo flet se është “besnike e idealeve dhe amanetit të dëshmorëve,

¹ Kumanovë, mediat: dorëzohen 22 persona të armatosur, të tjerët refuzojnë. *Shqip*, 9 Maj 2015.

[dhe se] do të luftojë deri në fund, për një shtet shqiptar kombëtar, të lirë dhe të pastër”!

Realizimi i objektivit “për një shtet shqiptar kombëtar, të lirë dhe të pastër” nga UÇK nënkupton shumë dinamika. Por unë do të përqendrohesha në dy konceptet e fundit: “të lirë” dhe “të pastër” — duke ngritur një pyetje: ‘të lirë’ dhe ‘të pastër’, nga cilët? Hamendësisht nga maqedonët! Qasjen e ‘pastërtisë’ së një kombi e kanë adoptuar historikisht nazifashistët. Por le të shpresojmë se me ‘pastërti’ ata nënkuptojnë “diçka” tjetër.

Kështu, është e qartë se kjo ushtri keqparaqet çdo betejë për “çlirim social e kombëtar”: sepse betejat për çlirim fillojnë “nga njerëzit e shtypur” dhe nuk mund të nxiten “nga jashtë”, cilëtdo qofshin ata. Dhe këtu bëhet fjalë për “çlirim social e kombëtar”. Jo vetëm për “çlirim kombëtar”. Ky i fundit historikisht është përfaqëuar nga “Balli Kombëtar” në Shqipëri i cili bashkëpunoi me Nazistët! Shkurt, kjo ushtri, nëse mund t’a quajmë ‘ushtri’, nuk mund të përfaqësojë gjithë kombin shqiptar, për sa kohë që ajo shkel çdo princip për ‘përfaqësim’ dhe për ‘çlirim’. Por atje është edhe një kontradiktë tjetër: se ata treguan mungesë organizimi ushtarak meqëse shkuan si çjapi te kasapi. Sepse nëse do të kishin qenë vërtetë ushtarakë — ata nuk do t’a kishin ndërmarrë aksionin në fjalë — sidomos në kushtet aktuale kur qoftë Shqipëria qoftë Kosova janë në krizë të thellë.

Shteti i Maqedonisë, në anën tjetër, vuan nga gjithçka vuajnë shtetet fqinje për mos të thënë gjithë shtetet e integruar në Rendin e Ri Botëror (RRB) të Globalizmit Neoliberal (G/N) plotësisht apo/ose pjesërisht. Kështu, së pari, në Maqedoni nuk ka patur asnjë organizatë politike që të luftojë për Vetëvendosje dhe bashkim kombëtar. Partitë politike shqiptare atje kanë adoptuar të njëjtën qasje me partitë në Shqipëri: të integrohen në globalizmin neoliberal. Së dyti, Maqedonia ka instaluar kuadrin modern institucional të “demokracisë” përfaqësuese dhe të tregut të marketingut si gjithë vendet e tjerë ku heteronomia dhe shfrytëzimi i njeriut nga njeriu është karakteristika bazë e shtetit. Përqendrimi i pushtetit në pak duar rrjedhimisht bëhet i pashmangshëm. Ekofashizmi, në kuptimin e tij të dyfishtë — ekonomik dhe ekologjik — bëhet gjithashtu i pashmangshëm. Akuzat se shteti maqedon është fashist dhe se rrugëzgjdhja është zhbërja e Maqedonisë, një proces që nënkupton bashkimin e shqiptarëve të Maqedonisë me Shqipërinë, të cilat na vijnë nga qarqe “patriotike” shqiptare, janë pa bazë shkencore. Sepse shteti i Maqedonisë vuan nga gjithçka vuajnë shtetet e tjerë: korrupsioni, varfëria, pabarazia ekstreme etj. Edhe nëse e pranojmë këtë qasje dhe bashkojmë shqiptarët e Maqedonisë me Shqipërinë, çështja e ekofashizmit të organizuar, siç kuptohet më lartë, në Shtetin Shqiptar (dhe Kosovën), me kuadrin aktual institucional, nuk mund të marrë zgjidhje.

Përdorimi i Skënderbeut, në anën tjetër, si frymëzim për çlirimin e trojeve shqiptare nga këto qarqe është kontradiktor: sepse Skënderbeu, pikërisht sepse ishte 'strateg' (ky koncept nënkupton njohje të mirë të strategjive ushtarake, avantazhet dhe disavantazhet e palëve në luftë dhe, të politikave ndërkombëtare) — fitonte në betejat e tij kundër Perandorisë më të madhe të kohës. Ai, për më shumë, kishte marrë votëbesim nga populli shqiptar për t'a udhëhequr në beteja luftarake; kishte krijuar kushtet dhe kishte përballë një armik të dukshëm. Ndryshe nga ajo kohë, shqiptarët që luftojnë për 'liri', jo vetëm që nuk kanë krijuar kushtet në 'gjirin' e shqiptarëve të shtypur (në Maqedoni etj.) por ata, ndryshe nga Skënderbeu, bashkëpunojnë me Perandorinë e ditëve tona: SHBA-në! D.m.th. ata bashkëpunojnë me strumbullarin e pushtetit botëror për të zëvendësuar një pushtet rajonal më të vogël. Për më tepër, bashkëpunojnë me një pushtet që jeton mijëra kilometra larg tyre për t'u zvjerdhur nga një pupoull me të cilin kanë jetuar dhe do të jetojnë në të njëjtën hapësirë gjeografike për mijëra vjet.

Kështu në vend që këto qarqe të zbulojnë armikun të vërtetë të popujve —kuadrin modern institucional dhe globalizmin neoliberal— dhe të bëjnë autokritikë për veprimtaritë luftarake spontane nga organizata të ndryshme, i përshtaten qasjes së përgjithshme se armiku është Gruevski i cili, për më shumë, mund të përdorë doktrinën ushtarake të terrorit shtetëror për qëllime politike nën flamurin e kundërshtarit (false flag)!²

Së treti, krizën në Maqedoni e shkaktoi udhëheqësi i opozitës, Zoran Zaev, kur zbuloi në publik se qeveria e Gruevskit përgjonte qytetarët. Sipas tij, përgjimet janë kryer me ndihmën e një agjencie të huaj! Partitë politike shqiptare kanë qendruar larg kësaj beteje. Kështuqë shfaqja e shqiptarëve të armatosur në Kumanovë nuk mund të ketë lidhje me luftën e partive në pushtet. Nga ana tjetër, qeveria aktuale ka përforcuar marrëdhëniet e saj me qeverinë ruse me emërimin e ambasadorit të ri në Moskë, Goce Karajanov, një ish anëtar i Institutit të Shtetit Rus për Marrëdhënie Ndërkombëtare. Ndërkohë që Rusia mbështeti Maqedoninë për arrestimet në Kumanovë në prill të këtij viti dhe dënoi përpjekjet e Zaev-it, për "Revolucionin e Ngjyrosur" që ka paralajmëruar. Ndryshe nga shumë vende rajonale, Maqedonia dërgoi presidentin e saj në ditën e fitores në Moskë dhe nuk mbështet sanksionet e Uashingtonit mbi Rusinë. Gazetat ruse dhe serbe, ndërkohë, propagandojnë krijimin e "Shqipërisë së Madhe".³ Problemi kryesor me këtë propagandë është se ajo nuk përmend asgjëkundi të drejtën e shqiptarëve për Vetëvendosje! As përmend ajo karakterin kryesor të shtetit modern: përqendrimin e pushtetit. Nuk do të ishte e çuditshme që qeveria Ruse e lidhi ngjarjen në Kumanovë me kundërshtimin e qeverisë maqedone të sanksioneve ekonomike të

² Ku(sh) janë terroristët e Kumanovës? *Redjan Shabani, Dita*, 13 Maj 2015.

³ The gears of war grind for greater Albania, *Andrew Korybko, Sputnik*, 12.05.2015.

Uashingtonit mbi Rusinë dhe linjën e gazit.⁴ Kjo përplasje kulmoi me shfaqjen e bisedës së ministres së brendshme, Jankulofska, ku fashistizohet kundër shqiptarëve të Maqedonisë. Qartësisht, ajo synonte të zemëronte dhe përfshinte në protestën e 17 Majit edhe shqiptarët.

Amerikanët, në anën tjetër, kuptuan se Rusia, me marrëveshjen që ka bërë me Turqinë - e më vonë me Greqinë (qeverinë SYRIZA)- se linja e re që mund të kalojë nga Maqedonia e më tej, përbri linjës "TAP", të cilën e kontrollon drejtpërdrejt Amerika, dhe burokratët e Brukselit, mund të sfidojë monopolin e saj. Në fjalë të tjera, do të kërcënohen fitimet që burojnë nga "TAP". Për të njëjtën arsye anulimi i gas-projektit të Rusisë në Ballkan nga Uashingtoni është prioritet. Nuk është e rastit që Uashingtoni përdor argumentin e 'varësisë' nga Rusia ndërsa shpërnjeh faktin e 'monopolizimit' të sektorit të energjitikës në rajon. Dhe nuk është e rastit që pas marrëveshjes së qeverisë Greke dhe Ruse, për linjën e Ballkanit, siç e pagëzoi Putin, meqëse kryeministrit të Greqisë i bënte alergji t'a quante Putin linjën "linjë turke", Uashingtoni "trodhi" për gati një javë ministrin e jashtëm grek, marksistin, Nikolaos Kotzias, duke e çuar në të gjitha "foletë" sioniste (AIPAC, B'nai B'rith etj.) dhe qendrat e tjera të marrëdhënieve ndërkombëtare (CSIS etj.). Menjëherë pas takimit Uashingtoni dërgoi emisarin e Departamentit të Shtetit të energjisë, Amos Hochstein në Athinë.

Nëse gjykojmë nga raportet e fundit,⁵ Uashingtoni po ushtron njëherësh presion në Athinë e Bruksel. Dhe, nuk është e rastit që Greqia operon unilateralisht në disa vende të "nxehtë" ndërkufitar për naftë dhe Uashingtoni hesht: sepse Greqia nënshkroi në vitin 2013 krijimin e një baze amerikane ushtarake në Jug të Greqisë për të vrojtuar me aeroplan pa ekuipazh (UAV etj.) gjithë rajonin!⁶ Për të realizuar këtë objektiv do të ishte normale që Greqia t'i kërkojë -për shkëmbim- Uashingtonit të përdorë diplomacinë dhe presionin e tij -nëse është e nevojshme- kundrejt Shqipërisë. Kjo e fundit, për më shumë, është pushtuar ekonomikisht kryesisht nga tre shete: Italia, Greqia dhe Turqia, dhe nuk ka pushtet politik për negociata.

Kështu, në vend të luftojnë për gazin rus, të dy vendet, Greqia dhe Shqipëria, me qëllim që të ushtrojnë presionin mbi çmimin e gazit të industrisë perëndimore dhe të ulin koston e prodhimit...ata po përdoren nga Uashingtoni dhe janë në proces të shkatërrimit jo vetëm të marrëdhënieve midis dy vendeve, por, gjithashtu, të ekosistemit të deteve tanë dhe përtej. Duhet theksuar këtu se qeveritë e Greqisë dhe Shqipërisë dominohen nga korporata Perëndimore naftë. Në fjalë të tjera, shfrytëzimi i burimeve të naftës do të realizohet kryesisht nga korporata amerikane. Dhe nëse është

⁴ Events in Macedonia linked to Turkish Stream, sanctions stance – Lavrov, *Sputnik*, 15/05/2015.

⁵ U.S urges Greece to reject Russian energy project, *N. Y. Times*, May 8, 2015.

⁶ Αμερικανική βάση στην Καλαμάτα, *Ελευθεροτυπία*, 13 Αυγούστου 2013.

për t'u penguar projekti i Rusisë – ai kalon edhe nga destabilizimi i Maqedonisë. Sepse nëse Maqedonia destabilizohet politikisht – Brukseli do të pezullojë çdo linjë gazi që mund të kalojë nga Maqedonia dhe Serbia drejt Europës.

Në fjalë të tjera, Uashingtoni po luan me dy (për mos të thënë më shumë) “gurë” njëherësh: elitën greke dhe Maqedoninë. Nëse elita greke e përparon projektin e Rusisë – Uashingtoni do të luajë me Maqedoninë. Nëse jo, Maqedonia nuk do të përdoret. Dhe nëse realizohet objektivi i pezullimit – Uashingtoni monopolizon tregun e gazit për 100 vitet e ardhshëm. Monopolizimin e tregut të gazit e kanë vendosur ndërmarrjet gas-naftë-nxjerrëse së fundmi, veçanërisht “Shell”.⁷ Kjo është një luftë, siç citojnë administratorët e ndërmarrjeve ndërkombëtare, se kush do të dominojë tregun europian të energjisë për 100 vitet ardhshëm. Veçanërisht tani, kur prodhimi i naftës dhe gazit të reshpeve amerikane është në kulmin e tij dhe kur Arabia Saudie kërkon të zgjasë epokën e naftës!⁸ Sepse sa më i madh të jetë kontrolli i tregut aq më shumë do të kontrollohen politikat e Brukselit. Nëse realizohet objektivi i Uashingtonit atëherë kostua për popujt europian do të jetë tejet e madhe: sepse monopolizohet tregu i energjitikës në pak ndërmarrje perëndimore. Dhe kur monopolizohet sektori bazë i ekonomisë – energjika – krijohen kushtet për krijimin e karteleve “nga lartë”.

Ne mund të konkullojmë se demokracia fillon përgjithësisht nga mbështetja dhe veçanërisht nga zhvillimi i Vetëvendosjes (antonimi i këtij koncepti është “tjetërvendosje”) së popujve. Por, në shtetin modern, ku heteronomia (tjetërvendosjesja) është institucionalizuar, Vetëvendosja (ose autonomia) s’ka asnjë kuptim. Ose mund të ketë nëse populli “vetëvendos” përmes “tjetërvendosjes” (përfaqësuesve). Por kjo është kontradiktë e qartë. Dhe është e vërtetë se Kumanova është një qytet me popullatë të përzier ku dominojnë maqedonët por, është e sigurtë se me politikat asimiluese (siç kanë treguar shumë dokumentarë) që ka ushtruar Maqedonia dekadat e fundit - shumë “maqedonë” janë shqiptarë. Kjo bëhet e pashmangshme meqëse maqedonët dominojnë institucionet publike. Të njëjtat politika janë imponuar mbi të gjithë minoritetet në vendet e Ballkanit (Greqi etj.).

Sidoqoftë, përballja e vërtetë në Maqedoni është midis Amerikës dhe Rusisë. Kjo e fundit, ka ngurrar, edhe një herë, për të akuzuar dhe denoncuar Uashingtonin në Kombet e Bashkuar. Sepse Rusia është ende një anëtare e OBT-së dhe Uashingtoni duhet të respektojë përpjekjet e Rusisë për të tregëtuar prodhimet e saj në Europë. Por, Rusia hesht! Në anën tjetër, Europa ndjek verbërisht politikat e Uashingtonit. Në vend që të mbështesë projektin e Rusisë ajo është orientuar të shfrytëzojë, siç bën Uashingtoni

⁷ Shell strikes £47bn agreed takeover of BG, *FT*, April 8, 2015.

⁸ Saudi claims oil price strategy success, *FT*, May 13, 2015.

dhe Londra, natën dhe gazin e reshpeve. Ky orientim do të shkaktojë –përtej kostove ekonomike për Europën- katastrofa të mëdha mjedisore.

Kështu, ngaqë Uashingtoni nuk do t'a respektojë Rusinë, dhe Europa nuk ka forcë t'a kundërshtojë atë, Rusia ka vetëm një alternativë: të braktisë OBT-në dhe të ndërtojë një ekonomi të pavarur duke vendosur kontroll kapitali dhe duke institucionalizuar në të njëjtën kohë politikat keinsiane. Menjëherë sa të jetë kryer kjo, Unioni Euroaziatik do të jetë alternativa e vërtetë për kombet e Europës Lindore dhe përtej. Kryesisht, për ato organizata politike të cilat kundërshtojnë RRB të G/N, dhe së dyti, për krijimin e parakushteve për një kuadër tjetër institucional në të cilin të gjitha format e pushtetit do të ndahen mes popujsh.

Çështja për shqiptarët në përgjithësi dhe shqiptarët e Maqedonisë në veçanti tashmë shtrohet se si të përfitojnë nga kjo gjendje. Së pari, ata duhet të distancohen nga opozita maqedone në pushtet dhe të mos marrin pjesë në protestën e rradhës. Së dyti, ata duhen të kërkojnë transparencë për ngjarjen në Kumanovë. Së treti, ata duhet të përgatisin kushtet për shkëputje nga Maqedonia dhe bashkim me Shqipërinë: sepse cilido që të jetë në pushtet – shqiptarët njëloj do të vuajnë. Dhe shkëputja dhe bashkimi kalon nga shfrytëzimi i të drejtës ndërkombëtare: duke kërkuar referendum popullor.

*Kjo analizë u publikua thuhet në të njëjtën kohë në *Pravda ru*. Këtu është një variant më i zgjeruar:

http://english.pravda.ru/opinion/columnists/21-05-2015/130675-macedonia_usa_russia_confrontation-0/